



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT  
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE  
DREJTORIA E ÇËSHTJEVE JURIDIKE**

Nr. 596/1 prot.

Tiranë më 4 .4 .2018

Lënda: Mendim mbi projektvendimin “Për miratimin në parim të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Eurojust-it dhe Republikës së Shqipërisë”.

**Znj. Etilda GJONAJ (SALIU)**

**MINISTËR I DREJTËSISË**

**Tiranë**

Në përgjigje të shkresës tuaj nr. 3641 Prot., datë 28.03.2018, projektvendimi “Për miratimin në parim të marrëveshjes për bashkëpunim ndërmjet Eurojust-it dhe Republikës së Shqipërisë” vlerësohet i hartuar konform ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Ky qëndrim është reflektuar edhe në takimin e zhvilluar në Hagë ndërmjet delegacionit të Eurojust-it dhe atij të Republikës së Shqipërisë ku përfaqësues të Zyrës së Komisionerit kanë qenë pjesë e grupit negociues mbi variantin përfundimtar të marrëveshjes.

Vlerësojmë që në përmbajtje të saj, (në versionin e përkthimit zyrtar në gjuhën shqipe), në pikën 2 të nenit 19 të marrëveshjes, togfjalëshi “Nëpunësi për Mbrojtjen e të Dhënave i Eurojust-it”, dhe “Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave e Republikës së Shqipërisë”, të zëvendësohen me: “Oficeri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale i Eurojust-it”, dhe “Autoriteti për Mbrojtjen e të Dhënave në Republikën e Shqipërisë”, me qëllim unifikimin edhe me terminologjinë ndërkombëtare.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

**KOMISIONERI**

**Besnik Deryishi**

